



## **Grimca Urtie**

*Përgatiti: Edin Q. Lohja*

## **MYSAFIRI I GJYKATËSIT**

Një njeri erdhi mysafir në shtëpinë e Imam 'Aliut. Ai ndejti mik për disa ditë, edhe pse i pafuar, duke ndrydhur diçka në gjoks të cilën s'kish mundur ta zbulonte që në fillim. Në të vërtetë, ky njeri kishte një mosmarrëveshje me dikë tjetër, dhe po priste që ai person të vinte në praninë e Imam 'Aliut, që të mund të vepronte kundër tij. Më në fund, ai e zbuloi çështjen dhe e ngriti padinë.

Imam 'Aliu e pyeti: "Atëherë, hëpërhë, ti je paditësi, apo jo?"

Njeriu iu përgjigj: "Po, o Prijësi i Besimtarëve."

Imami i tha: "Kërkoj ndjesë. Që sot, unë nuk mund të të ofroj mikpritje si mysafir në shtëpinë time. Sepse i Dërguari i Allahut (s) ka thënë: "Kur para gjykatësit paraqitet një padi, ai nuk ka të drejtë ta ftojë njërin palë, përderisa të mos jetë e pranishme edhe tjetra."

(Marrë nga libri "Tregimet e të Virtytshmëve" i Profesorit martir Murteza Mutahhari; cituar nga *el-Vasa'il*, vëll. III, fq 395)

## **GAZALIU DHE KUSARËT**

Gazaliu, dijetari i shquar islam, ishte me origjinë nga Tusi, një qytezë pranë Meshhedit të Iranit. Asokohe (rreth shek. V Hixhri), Nisaburi ishte qendra dhe kryeqyteti i zonës dhe shquhej si qendër akademike e dijes. Studentët që kërkonin dije udhëtonin në Nisabur. Edhe Gazaliu mbërriti atje.

Ai i vazhdoi me zell studimet e tij dhe fitoi njohuri nga profesorët dhe dijetarët e shquar, për shumë vjet. Për të mos harruar asnjë çështje të diturisë, e as për të mos i humbur frytet e vjelura nga duart e tij, ai mbante gjithmonë shënime nga leksionet dhe i bënte fletore. Ai i ruajti këto shënime - që ishin rezultatet e punës së tij të përkushtuar ndër vite - po aq sa edhe jetën e tij.

Vite më vonë, pasi kishte kryer studimet, ai vendosi të kthehej në vendlindje. Pasi i mblodhi të gjitha fletoret dhe i lidhi ato, ai u nis me një karvan për në shtëpi. Papritur, karvani u ndesh me një bandë hajdutësh dhe kusarësh. Ata e ndaluan karvanin dhe plaçkitën çdogjë që mundën të gjenin në të. Më në fund, i erdhi rratha Gazaliut dhe plaçkës së tij.

Teksa po vinin dorë mbi togun e fletoreve të tija, Gazaliu filloi të qajej e të përgjërohej duke thënë: "Merrini të gjitha që kam, por ju lutem ma lini këtë tog!"

Grabitësit menduan se në togun e lidhur mesiguri duhet të kishte gjëra shumë të çmueshme dhe të vjera. Ata e zgjidhën, por s'panë gjë tjetër veç disa letrave të shkruara. Ata e pyetën: "Ç'janë këto dhe përse duhen?" Gazaliu u tha: "Çfarëdo që të jenë, për ju s'kanë asnjë dobi, por për mua kanë vlerë të madhe."

Kusarët e pyetën: "Po ç'të duhen ty ato?" Gazaliu u përgjigj: "Këto janë frytet e punës sime të lodhshme gjatë shumë vjet studimesh. Nëse m'i merrni, dituria ime do të zhduket dhe të gjitha vitet e përpjekjeve të mia në rrugën e dijes, do të shkojnë kot."

Plaçkitësit ia kthyen: "Domethënë, dija jote ndodhet në këto letra, apo jo?"

Po, - tha Gazaliu. Kusarët atëherë i thanë: "Dija që ndodhet në një trastë e që mund të vidhet lehtë, nuk është dije. Shko e mendohu mirë për veten tënde."

Kjo vërejtje e thjeshtë dhe e zakonshme e shkundi thellë në shpirt e në mendje Gazaliun. Ai e kuptoi se gjer në atë ditë kishte qenë si një papagall, që hidhte në letër gjithçka që dëgjonte nga profesorët.

Që nga ajo ditë, ai mendoi të bënte ç' ishte e mundur për ta stërvitur mendjen me anë të thellimit, soditjes, hulumtimit, dhe regjistrimit të lëndëve të dobishme në kokë.

Gazaliu shpesh pohonte: “Këshilla më e mirë që u bë praktika e jetës time intelektuale ishte ajo që dëgjova nga një kusar karvanesh.”

(Marrë nga libri “Tregimet e të Virtytshmëve”)

## ALEKSANDRI DHE DIOGJENI

Aleksandri i madh, mbreti i Maqedonisë, ishte zgjedhur kryekomandant i Greqisë për të udhëhequr ushtrinë kundër Iranit; njerëz nga të gjitha shtresat e shoqërisë kishin ardhur ta përgëzonin. Por Diogjeni, më i mençuri i Greqisë, i cili jetonte në Korinth, s'i kushtoi as vëmendjen më të vogël atij. Aleksandri shkoi personalisht ta takonte. I njohur si një nga burrat e urtë, slogani i të cilit ishte: Vetëpërmbytje, zemërgjerësi, pavarësi dhe maturi në jetë, Diogjeni ishte shtrirë përtokë nën ndriçimin e diellit të asaj dite të kthjellët. Duke parë se një numër njerëzish po vinin drejt tij, ai u ngrit pak dhe ia nguli sytë Aleksandrit, i cili po afrohej me mburrje. Ai iu duk si një person i zakonshëm që po vinte ta takonte duke respektuar motot e parimeve të shpirtmadhësisë dhe lirisë. Aleksandri e përshëndeti, dhe e pyeti nëse kishte ndonjë kërkesë.

Diogjeni u përgjigj: “Dua vetëm një gjë prej teje: Po shijoj ndriçimin e diellit dhe ti erdhe e më pengove, ndaj lëviz pak mënjane, të lutem!”

Këto fjalë tingëlluan si të vogla dhe të parëndësishme në sytë e shoqëruesve të Aleksandrit. Ata menduan se sa i trashë ishte treguar ai duke mos përfituar nga një mundësi kaq e madhe. Por Aleksandri, i cili u ndje i mospërfillur përpara madhësisë së sjelljes dhe lartësisë së dinjitetit të Diogjenit, ra në mendime. Pasi e përshkoi rrugën e tij kokulur, ai u tha shoqëruesve të tij të cilët po e tallnin filosofin: “Në të vërtetë, po të mos isha Aleksandër, do të doja të isha Diogjen.”

(Marrë nga libri “Tregimet e të Virtytshmeve”; cit. nga George Sarton, *History of Science*, fq 525)

## KËSHILLA E VYER

Imam ‘Ali ibn Husein Zejn ul-‘Abidinit iu kërkua nga i biri, Muhammed el-Bakir, t’i jepte një këshillë. Imami i tha:

- “O bir, mos u shoqëro, mos fol, e as mos rri me pesë lloje njerëzish.”
- “Cilët janë ata, o baba?” pyeti i biri, dhe Imami u përgjigj:

“Kujdes nga shoqëria e gënjeshtarit, sepse ai është si mirazhi: të largon atë që është pranë, dhe të afron atë që është larg. Kujdes nga shoqëria e mëkatarit, sepse ai do të të zhgënjejë për një kafshatë të vetme, e madje edhe më pak. Kujdes nga shoqëria e koprracit, sepse ai do të të lërë në baltë kur t’ia kesh më shumë nevojën. Kujdes nga shoqëria e budallait: ndonëse synon të të bëjë mirë, ai vetëm të sjell dëm; dhe kujdes nga shoqëria e shpërfillësit të farefisnisë, sepse e kam parë të mallkohet në Librin e Allahut.”